



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:014499
Datë: 07.12.2023
Numri i dokumentit: 05029094

C-IV.-14-1491

Ankuesi

I H,

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 07 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit hedhet poshtë si e palejueshme.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 13 mars 2014, ankuesi parashtroj ankesë kundër Vendimeve të Autoritetit të Likuidimit PRN046-0711, PRN046-0712 dhe PRN046-0713, me të cilin i janë refuzuar kërkesat nga N.SH FAN “Zahir Pajaziti” (në likuidim). Ankuesi i ka propozuar gjykatës aprovim e ankesës.

Me 11 tetor 2016, e paditura parashtroj përgjigje në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht.

E paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar si dhe në kuptim të provuarit sipas nenit 7 të Ligjit mbi procedurën kontestimore ku theksohet se “palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, e te

cilën ankuesi nuk e ka bërë. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së. AKP.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit hedhet poshtë si e palejueshme.

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit ka zbatuar dispozita e Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Neni 391 pika c) e Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore thotë:

Gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenca);

Po ashtu nenin 262, para 3 dhe 4 i LPK-së thotë:

262.3 “Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë”

262.4 “Gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta.”

Gjykata lidhur me ankesën ankuesit e cila është objekt shqyrtimi ka kërkuar informata nga Zyra e Regjistrimit e Dhomës së Posaçme dhe pas verifikimit është vërejtur se ankuesi për të njëjtën çështje juridike, pra kundër të njëjtave vendimeve të Autoritetit të Likuidimit PRN046-0711, PRN046-0712 dhe PRN046-0713, ka paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme dhe se ankesa është regjistruara me dt. 13 mars 2014 si C-IV-14-1516. Po ashtu është vërejtur se edhe një ankesë tjetër e ankuesit e paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të likuidimit PRN046-0713 është regjistruara si C-IV-14-1493.

Pra meqë Gjykata ka vërejtur se ankesa ankuesit e paraqitur kundër vendimeve të njëjta dhe palëve të njëjta është regjistruara 3 herë në gjykata dhe ka marrë numra të ndryshëm, është e palejueshëm që edhe me tutje të ekzistoj si lëndë aktive në gjykatë rasti C-IV-14-1491.

Siç u arsyetua më lartë meqë për të njëjtën çështje të ngritur me ankesë kundër vendimeve të njëjta dhe palëve të njëjta ende figuron e regjistruara kjo lëndë, gjykata konform nenit 391, pika c) ankesën e ankuesit e hedhe poshtë si të palejueshme.

Andaj nga arsyet si me lart Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar